



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ZYRA E PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM**

---

Nr. 2031 Prot.

Tirane 10.10.2002

L Ë N D A: Mbi caktimin dhe vlerësimin e masave të sigurimit

**PROKURORIVE PRANË RRETHIT  
GJYQËSOR TE SHKALLES SE PARE**

**PROKURORIVE TE APELIT \_\_\_\_\_**

Nga kontrollet e ushtruara ne disa Prokurori pranë rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë dhe Prokurori të Apelit, konstatohet se në disa raste nuk zbatohen me korrektësi kërkesat e K. Pr. Penale, për caktimin dhe vlerësimin e masave të sigurimit.

Në kërkesat e Prokurorit për caktimin e masave të sigurimit ose të vlerësimit, të ndalimit apo arrestimit në flagrancë, shpeshherë nuk respektohen nenet 228, 229, dhe 230 të K. Pr. Penale, duke sjellë për pasojë jo vetëm mospranimin e kërkesave të Prokurorit në shkallë të parë, por dhe ndryshimin e vendimeve të Gjykatës në Apel dhe në Gjykatën e Lartë.

Kërkesa për vlerësimin dhe caktimin e masave të sigurimit nuk duhet të mbështetet në formularët tip që ju dispononi, për faktin se ato nuk të krijojnë

mundësinë për të arsyetuar kërkesën dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, ato duhet të përpilohen nga Prokurori i çështjes duke trajtuar:

1-Veprën penale që i atribuohet personit ndaj të cilit kërkohet masa e sigurimit.

2-Aktet procedurale të administruara deri në atë fazë të hetimit paraprak, duke i trajtuar juridikisht të lidhura me përmbajtjen e veprës penale që i atribuohet personit që kërkohet masa e sigurimit, të cilat përbëjnë dyshimin e arsyeshëm se është kryer vepra penale nga autori.

3-Kriteret për caktimin e masës së sigurimit dhe kriteret e veçanta kur kërkohet masa e arrestit në burg.

Kërkesës për vleftësimin e arrestit ose ndalimit, dhe të caktimit të masës së sigurimit krahas akteve të tjera, duhet t'i bashkëlidhen të gjitha aktet procedurale që përbëjnë dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në prova deri në momentin e përpilimit të kërkesës për masën e sigurimit personal, të cilat duhet të shqyrtohen nga Gjykata dhe të administrohen në fashikullin e masës së sigurimit në Gjykatë.

Mosargumentimi i kërkesës për caktimin e masës së sigurimit dhe moshoqërimi i saj me aktet procedurale që evidentojnë dyshimin e arsyeshëm të bazuar në prova, dhe administrimit të tyre në fashikullin e masës së sigurimit në Gjykatë, jo vetëm që përbën shkelje të rëndë procedurale, por pengon Gjykatën për të caktuar atë masë sigurimi që kërkon Prokurori.

Gjatë shqyrtimit të masave të sigurimit në Gjykatat e Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, konstatohet se në fashikujt e masave të sigurimit të Gjykatës së Shkallës së Parë, në të shumtën e rasteve vendosen pjesërisht ose mungojnë aktet mbi të cilat pretendohet nga Prokurori se ekziston një

dyshim i arsyeshëm se është kryer vepra penale nga autori që kërkohet masa e sigurimit personal. Mosarsyetimi i kërkesave dhe mosadministrimi i këtyre akteve, ka ndikuar në Gjykatat më të larta të ndryshojnë vendimet e Gjykatës së Shkallës së Parë në zbutjen e masave të sigurimit, kryesisht në ato me arrest në burg.

Krahas detyrimit ligjor që kanë Prokuroritë pranë rrethit Gjyqësor të Shkallës së Parë, të dokumentojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të caktimit dhe vlerësimit të masës së sigurimit personal, edhe Prokuroritë e Apeleve si organ më i lartë dhe i centralizuar i Prokurorisë, kur konstatojnë mangësi të akteve në fashikullin e masave të sigurimit duhet të bashkëpunojnë me Prokuroritë e rretheve. Ky bashkëpunim duhet të realizohet jo vetëm për t'u njohur me fashikullin e procedimit penal të hetimit paraprak të Prokurorit, por ndërkohë, para dhënies së konkluzioneve në Gjykatën e Apelit, të riparohen gabimet e mundshme nga Prokurorët e Shkallës së Parë.

Ky material të punohet me Prokurorët për të përmirësuar punën në të ardhmen.

**PROKURORI I PERGJITHSHEM**

**THEODHORI SOLLAKU**



